



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër
02.nr. Zyrtarisht/22.
Deçan, 09.02.2022


Për: Kryetarin e Komunës së Deçanit
Z. Bashkim Ramosaj

Nga : Drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Deçan
Z. Agron Muslijaj

Lënda: Plan Pune për vitin 2022, i Drejtorisë



Së bashku me këtë shkresë do gjeni edhe planin e punës për vitin 2022 për Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrit në Deçan.



PLAN P U N E

Për periudhën Janar – Dhjetor 2022 i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Deçan

1. Shefi i Sherbimit njëkohësisht edhe zyrtari për RDPP së bashku me referentën e ndryshimeve kadastrale

Meqenëse Drejtoria jonë Kryesisht punon në bazë të kërkesave të palëve , nuk kemi mundësi reale që të caktojmë volumin e punëve për vitin 2022, por ne duke u bazuar në statistikat që i mbajnë për çdo vit mendojmë se në këtë vit do të ketë trend të rritjes së volumit të punëve , krahasuar me vitet paraprake.

Në vazhdim në bazë të punëve të kryera në vitet e kaluar dhe bazuar në trendin e rritjes së kërkesave të palëve po japin një pasqyrë e cila do na shërbejë si orientim i synimeve të kryerjes së punëve brenda vitit raportues dhe atë për secilin vend pune.

Zyrtari për RDPP – njëkohësisht Shefi i Drejtorisë për Kadastër dhe Zyrtarja e Ndërrimeve kadastrale planifikojnë që në këtë vit të shqyrtojnë përafërsisht **700-800** kërkesa të palëve të cilat kanë të bëjnë me ndërrimin e pronarëve dhe futjen e të dhënave të reja në sistemin e SIKTK- es.

Krahas këtyre punëve Zyrtari për RDPP i cili i kryen edhe detyrat e shefit të shërbimit i njëjti kryen edhe punë tjera nga lëmi i shërbimeve pronësoro dhe së bashku me Referentën për ndryshime kadastrale kryejnë edhe punë tjera me urdhër të drejtorit dhe sipas nevojës .



2. Zyrtarët e mirëmbajtjes së Kadastrit

Në këtë sektor punojnë tre zyrtar për mirëmbajtjen e Kadastrit

Këta zyrtar gjatë periudhës 01.01.2022 deri 31.01.2022 mendojmë se do kryejnë afro **350** raste terreni sipas kërkesë së palëve për të cilat do bëjnë azhurimin adekuat nëpër librat kadastral dhe më pas do i dërgojnë te Juristi për marrje të vendimeve adekuate .

Punët në teren do i kryejnë Kompanitë dhe Gjeodetët e Licencuar për shkak se në nuk se me ligje kjo punë iu është lënë vetëm Gjeodetëve dhe Kompanive Gjeodete të Licencuara.

Gjithashtu këta zyrtar mendojmë se do kryejnë me tepër se 55 raste të lëshuarjes së Historiateve si dhe do dalin në teren sipas nevojave dhe kërkesave zyrtare të Komunës.

Të njëjtit do kryej edhe detyra tjera sipas nevojave të cilat paraqiten në këtë shërbim siç janë konsultat me palë dhe punë tjera në zyre.


3. Referenti për pranimin e palëve

Gjatë kësaj periudhe , referenti për pranimin e palëve mendojmë se do pranojë përafërsisht **4000** kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me dhënien e certifikatave të pronës së paluajtshme, kopjeve të planit dhe vërtetimeve me të cilat vërtetohet se a ka apo nuk ka pala pasuri të paluajtshme, në territorin e Komunës etj..

I njëjti zyrtar i procedon të gjitha këto kërkesa dhe për secilën kërkesë palët pajisen me dokumente përkatëse në afatin brenda ditës së paraqitjes së kërkesës.

Ky plan i punës nuk parasheh 100% punët që do kryhen gjatë vitit 2022 por siç u tha edhe më lart është plan orientues i cili është përpiluar duke u bazuar në statistikat e punëve të kryera nga vitet paraprake i që shihet se për secilin vit ka tendenca të rritjes volumit të punës.

Raportin e hartoi :
Shefi i kësaj Drejtorie
Hasan Hula



Planin e Aprovoi :

Drejtori
Agron Muslijaj

